

ROMANI “BIJTË E ASKUJT” I REXHEP QOSJES NËN PRIZMIN NARRATOLOGJIK

Fatbardhe HASI

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
fatbardhe.hasi@gmail.com

Abstrakt

Rexhep Qosja është ndër shkrimtarët eminent të letërsisë mbarë shqiptare.

Letërsia shqipe në vitet shtatëdhjeta është pikëtakuar më atë botërore falë krijimtarisë së këtij autori, konkretisht me romani i tij i parë “Vdekja më vjen prej syve të tillë”.

Më pas të gjithë romanet e tij kanë lënë vullë dhe janë model se si duhet krijuar një letërsi e mirëfilltë.

Romani “Bijtë e askujt”, ka një narracion të dallueshëm sepse ai përbëhet nga dy linja narrative, kjo gjë i mundëson romanit të lexohet si *dy në një*. Pra, janë dy histori paralele që rrugëtojnë brenda një romani. Kështu, romani ka dy protagonist kryesor jeta e të cilëve rrëfëhet e që janë edhe personazhet më fatkeq të romanit, sepse ata janë të detyruar ta braktisin vendin e tyre pa dashje, njëri në komunizëm e tjetri në demokraci. Këtë fatkeqësi të protagonistëve të tij Qosja i ka përkufizuar si *bijtë e askujt*, duke e bërë këtë emërtim edhe titull të romanit.

Fokusimi ynë në këtë punim janë elementet e teorisë së narratologjisë, se si ato praktikohen nga autori Qosja, gjë kjo që nënkupton se edhe metoda e punës është ajo narratologjike. Konkretisht do të ndalemi në identifikimin dhe klasifikimin e narratorëve; në ndërtimin dhe paraqitjen e personazheve; në elementet e kohës dhe vendit. Varësisht ecurisë së punimit mund të ndërfiten edhe elemente të tjera narratologjike.

Fjalët kyçe: Miran Bushati,, Delina Derti, narratori, personazhet, koha, hapësira.

Hyrje

Romani *Bijtë e askujt* i Rexhep Qosjes është një ndër veprat më të rëndësishme të autorit, mirëpo edhe të letërsisë shqipe në përgjithësi. I shkruar në fillimshkullin njëzetën, romani trajton histori të një shekulli më parë, duke bërë një reflektim të thellë në realitetin historik e shoqëror, i krijuar mbi bazën e një ideologjie siç ishte ajo komuniste. Më këtë roman Qosja ka sjell një rrëfim për një periudhë të tensionuar historike duke paraqitur të njëjtën ideologji komuniste të ndarë në dy shtete të ndryshme, si dhe ndikimin e pasojave që e njëjta ideologji me të njëjtat kauza kishte shkaktuar në dy shoqëri.

Rrëfimi në roman ka një strukturë komplekse dhe kërkon një lexim shterues dhe analitik. Kjo është edhe arsyeja që romani të analizohet nën prizmin narratologjik, ku metoda e punës së aplikuar ofron mundësi dhe jep mënyra për të parë se si është ndërtuar romani si përcillet rrëfimi, dhe çfarë funksioni kanë këto elementet në krijimin e mesazhit që romani donë të transmetojë.

Metoda e narratologjisë si fushë studimi ofron mjete të fuqishme teorike për analizim të veprave letrare. Fokus kryesor sipas kësaj metode është mënyra se si rrëfëhet historia. Kush e rrëfen ngjarjen si paraqiten narratorët; cilat janë këndvështrimet narrative si janë ndërtuar personazhet, si dhe ndikimin e kohës dhe të hapësirës në narrativën e romanit. Arsyeja për ta analizuar romanin *Bijtë e askujt* bazuar në këtë metodë është bërë nisur nga bindja se struktura narrative e romanit ofron material të hollësishëm, në të cilin mund të mbështeten termet narratologjike për të deshifruar kompleksitetin e veprës.

Ky funksionim ka për qëllim të analizojë elementet kryesore natratologjike në roman. Synimet kryesore të studimit janë: 1. Paraqitje e shkurtër për autorin; 2. Analizimi i teknikave narrative në roman; 3. Pozicioni, identifikimi dhe funksioni i narratorëve brenda veprës; 3. Funksioni dhe

rëndësia e personazheve brenda romanit; 4. Konceptet kohë dhe hapësirë si elemente ndërvepruese në strukturën narrative.

Për të arritur këto synime, është aplikuar metoda narratologjike me elementet e saj identifikuese duke bërë analizimin e tekstit bazë, siç është romani, për të paraqitur se si ndërtimi struktural i veprës ndikon në transmetimin e përmbajtjes dhe identifikimin e stilit krijues të autorit. Duhet pasur parasysh këtu që Qosja ka përfshirë brenda romanit një numër të madh zhanresh letrare, zërash narrativ dhe aspekte të tjera kulturore të cilat e bëjnë romanin një përzierje hibride që kërkon analizim të hollësishëm përmbajtësor e struktural.

1. Për autorin

Rexhep Qosja (1936), është ndër figurat më të shquara që ka letërsia shqipe. Bagazhi intelektual dhe titujt që gëzon Qosja janë të shumtë. Ai është anëtar dhe ndër figurat më të shquara që Akademia e Kosovës ka. Po ashtu është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shqipërisë. Është ndër historianet, shkrimtarët, kritikët, publicistët më të shquar në kulturën shqiptare. Kontributi i tij në çështjen shqiptare është shumë i hershëm dhe gjatë gjithë jetës nuk u ndal së kërkuari dhe së përpjekuri për një jetë më të mirë dhe më të dinjitetshme të popullit shqiptar në përgjithësi.

Qosja ka qenë i përfshirë në të gjitha sferat kulturore dhe politike kosovare dhe me gjerë. Por ai mbetet i dalluar dhe i veçantë në krijimtarinë dhe kritikë letrare. Është i dalluar kontributi i tij në kritikën letrare shqiptare, veçanërisht me periodizimin e romantizmit shqiptar ku ka shkruar historinë e romantizmit shqiptar në tri vëllime. Ndërsa në krijimtarinë letrare Qosja është i dalluar për zhvillimin e gjinisë së dramës dhe romanit. Në dramaturgjë ka një seri titujsh të cilët e bëjnë të veçante edhe si dramaturg të dalluar për prurjet e tij në dramën shqipe. Proza është një tjetër gjini të cilën Qosja e krijon me pasion.

Rexhep Qosja është studiues dhe shkrimtar që ka pasuruar letërsinë shqipe në shumë aspekte. Ai është: themeluesi një metode të studimit (metoda integrale); themelues i një forme të dramës (monodramëa); themelues i një formacioni letrar (postmodernizmi). (Apolloni, 2016)

2. Narrativa

Teoria narrative shtron rrugën për të orientuar se si duhet të lexohet një tekst. Ajo jep alternativa duke ngritur pyetje përmes së cilave krijohen dilemat se si një tekst i caktuar e ka të zhvilluar narracionin. Kush rrëfen dhe sa është numri i zërave narrativ; si është rendi temporal që ngjarja në tekst i përmbahet, a është thjeshtë një rrëfim kronologjik i ngjarjeve apo kemi ndërhyrje temporale si analepsës, prolepse etj; si janë ndërtuar personazhet, deri në far niveli dhe a formohen ato si karaktere; cili është lokacioni ku zhvillohen ngjarjet dhe sa ndikon ambienti në një situatë të caktuar.

Me fjalë të tjera, një teori që definon dhe përshkruan narrativitetin, jo narrativen; jo zhanrin apo objektin por mënyrën kulturore të të shprehurit. (Bal, 2021)

Të rrëfesh do të thotë të tregosh për një storje të caktuar. Rrëfimi nuk ka një vijë lineare të cilën e ndjekë, dhe për të njëjtën storje mund të ndërtohen rrëfime të ndryshme. Kurse storja është vija kronologjike e ngjarjes apo si e ka përcaktuar Forster:

Storja është rrëfimi i ngjarjeve të renditura simbas rrjedhës kohore – darka vjen mbas mëngjesit, e marta mbas të hënës, kalbja mbas vdekjes e kështu me radhë. (M.E.Forster, 2017)

Letërsia që ka krijuar Rexhep Qosja është model ku mund të praktikohen konceptet e teorisë narrative. Shumëzëshmëria e narratorëve, llojllojshmëria e personazheve, thyeshmëria kohore, vendi dhe hapësira ku ngjarjet rrëfohen bëjnë që teoria narrative të gjejë aplikim dhe të dëshmohet me shembuj konkret në krijimtarinë e Qosjes.

Struktura e ndërtimit të romanit *Bijtë e askujt* është e larmishme. Aty zënë vend të gjitha llojet e shkrimit kjo bën që romani të kapërcej kufijtë e tij zhanror duke shkuar një shkallë më tej,

ku brenda një strukture frymojnë pothuajse të gjitha gjinitë dhe llojet e shkrimit letrar. Romani *Bijtë e askujt*, ka një narracion të dallueshëm sepse ai përbëhet nga dy linja narrative, kjo gjë i mundëson romanit të lexohet si *dy në një*. Pra, janë dy histori paralele që rrugëtojnë brenda një romani. Romani ka dy protagonist kryesor jeta e të cilëve rrëfëhet e që janë edhe personazhet më fatkeq të romanit, sepse ata janë të detyruar ta braktisin vendin e tyre pa dashje, njëri në komunizëm e tjetri në demokraci. Këtë fatkeqësi të protagonistëve të tij Qosja i ka përkufizuar si *bijtë e askujt*, duke e bërë këtë emërtim edhe titull të romanit.

2.1. Narratorët: Romani *Bijtë e askujt*, i kategorizuar edhe si roman polifonik nga vetë autori, dëshmon se zërat narrativ janë të shumtë, të cilët rrëfejnë dhe dëshmojnë për situata të ndryshme në roman.

Duke filluar nga narratori kryesor i cili njëherësh është edhe protagonist që prezanton veten në fillim të romanit:

Shumëçka ndodh papritur.

Papritur kam lindur.

Unë.

Miran Bushati (Qosja, 2016)

Kështu hapet romani “*Bijtë e askujt*”, me paraqitjen e protagonistit, narratorit e një herësh vetë autorin e romanit, sepse Qosja ia lë atij meritat për shkrimin e romanit, kryeprogonistit të quajtur Miran Bushati. Narratori i cili në këtë rast është krijuesi i romanit shpalos që në fillim arsyet se pse vendos ta shkruaj romanin dhe shfaq brengat se si do të shkoj puna e si do të dal përfundimisht romani. Preokupimin e tij rreth punës së krijimit të romanit e shpalos disa herë protagonistin, duke paraqitur procesin e punës si: mbledhjen e dëshmive, sigurimin e dokumenteve e më pas klasifikimin e tyre se çka duhet të përfshihet në roman e çka jo. Ky lloj shkrimi ku autori apo narratori e qoftë edhe personazhi e paraqet punën e tij gjatë krijimit është i njohur nga teoricientët me emrin *poioumenon*.

Narratori Miran Bushati rrëfen, sepse për të më të rëndësishme se njeriu janë rrëfimet për njeriun. Në atë rrëfim ai operon më çdo gjë. Aty flet për procesin e krijimit të romanit në të cilin edhe vetë është personazh. (Apolloni, 2016)

Miran Bushati në rolin e narratorit personazh ka dije të kufizuar për ngjarjet. Meqenëse atij i kërkohet të shkruaj një roman për fatin e një të përndjekuri në komunizëm ai është i detyruar të mbledh informacione dhe ta plotësoj romanin e tij me fakte, prandaj është e domosdoshme për të që të udhëtoj në Shqipëri (sepse Miran Bushati është shtetas amerikan dhe jeton në Amerikë) e më pas edhe në Kosovë.

Mbledhja e informacioneve fut në skenë edhe narrator të tjerë të cilët rrëfejnë për ngjarje dhe ndodhi që dinë për Tarik Saraçin – heroin e romanit.

Ashtu si e prezanton Qosja Miran Bushati në fillim, ashtu ua lejon prezantimin edhe narratorëve tjerë të cilët do të rrëfejnë për jetën e Tarik Saraçit.

Quhem Katalione, Roberto Katalione.

Dëgjova, para disa ditësh, mund të ketë një javë, mund të ketë dhjetë ditë, se një shqiptar prej Nju – Jorku vjen në Shqipëri për të hulumtuar vdekjen më misterioze në Shqipërinë komuniste: vdekjen e mikut tim të kohës studentore, Tarik Saraçi. (Qosja, 2016)

Katalione i cili mund të kategorizohet si një lloj narratori dëshmitar, nuk është se jep ndonjë informacion të veçantë për Tarik Saraçin. Ai me tepër shpalos një lloj informacioni për sëmundjet infektive, meqenëse me profesion ishte infektolog, dhe si duket rastësisht apo qëllimshëm e bën që gjithë ngjarjen e rrëfyer e lidh me profesionin e tij dhe thënë shkurt e trup ai më shumë rrëfen për vete se sa për Tarikun. Në fund fare shpalos një bisede të shkurtër që kishte me Tarikun dhe më pas i bën një përshkrim të shkurtër dukjes dhe një pjese të personalitetit të Tarik Saraçit. Përmes këtij lloj narratori dëshmitar mësojmë se si është dukur

vetëm sipërfaqësisht Tariku, për të cilin ai thotë që ishte djalë i pashëm dhe që të kujtonte Bajronin. Më Bajronin e lidh ndoshta edhe për faktin se edhe Tariku shkruante poezi.

Një lloj narratori metadiegetik siç e klasifikon Zheneti, është i aplikuar nga Qosja. Personazhi i quajtur Martin Mati i cili kishte qenë shokë në Normalen e Elbasanit me Tarik Saraçin, përveç që jep informacion shumë të imët në lidhje me Tarik Saraçin, gjithë rrëfimin e tij e bazon në një histori të një dite në Tiranë, teksa e pret Tarik Saraçin që të takohen. Pra, ai brenda historisë së madhe për Tarikun jep një histori të vogël të një dite e që është histori jo pak e rëndësishme, sepse aty paraqet një pjesë të realitetit të jetuar në komunizëm. Lypësi i cili i afrohet Martinut dhe i kërkon lëmoshë, nuk mund të jetë një lypës i zakonshëm. Veshja e tij jo e lekosur, mandej përcjellja që i ka bërë Martinut gjatë gjithë kohës si dhe kundërshtimi që i bën këtij të fundit kur i thotë se: *nuk më ngjanë në lypës, as ti nuk më ngjanë në komunist*, (Qosja, 2016) e forcon edhe më tepër mendimin e Martinut se ai nuk është një lypës i zakonshëm.

Më pas ngjarja që i ndodhë më një të panjohur në Dajt është një ndodhi tjetër jo pak e rëndësishme që e forcon rolin e Martinut në narrator metadiegetik:

E di kush i ka mbyllur? Nuk e di apo bëhesh se nuk e di. As unë nuk ta them. Pse t'i fus unë vetes pyka. Nuk jam budalla. As nuk jam i dehur. Kush guxon të dehet! Të gjithë duhet të jemi esëll! Duhet të jemi esëll edhe kur pimë! Duhet të jemi zgjuar edhe kur flemë! Duhet të jemi të ngirë edhe kur jemi të uritur! Duhet të qeshim edhe kur duhet të qajmë! Duhet...! Duhet...! Duhet...! Të jemi...! Të jemi...! Të jemi...!

Nuk e di si quheni! I them.

E kuptueshme se nuk e di. Pse ta dijë borgjezi i Kurrnajës se si quhet një proletar i Kryeqytetit. (Qosja, 2016)

Përfundimisht ajo për të cilën është i thirrur Martin Mati që të rrëfej nuk rrëfëhet sepse takimi më Tarik Saraçin nuk realizohet.

Tipin e narratorit homodiegetik e kemi ta pranishëm te dialogu i cili zhvillohet mes Moisi Milorit dhe Miran Bushatit. Moisi Milori, është personazh dytësor i cili rrëfen njohuritë e tij për personazhin kryesor pasiv. Themi pasiv pasi Tarik Saraçi nuk është personazh që vepron në rrëfim edhe pse është kryesor, janë të tjerët që rrëfejnë dhe ndërtojnë karakterin e tij.

Moisi Milor shpalos një pamje të personalitetit të Tarik Saraçit. Ai sjell informacion real duke qenë vetë pjesë e asaj që shpalos sepse në të kaluarën ai kishte punuar në një objekt me Tarik Saraçin. Informatat që i sjell ai konsiderohen që janë informata të marra drejtpërdrejt nga burimi parësor. Moisi Milor është pra një tjetër narrator që e shkruan jetëshkrimin për Tarik Saraçin ashtu siç e pohon Miran Bushati¹ (Qosja, 2016)

Numri i narratorëve që rrëfejnë në këtë roman është i madh. Kush më pak e kush më shumë kontribuojë në jetëshkrimin e Tarik Saraçit, mirëpo është një narrator dëshmitar i cili nuk duhet anashkaluar. Premt Dukagjini rrëfimin e tij për Tarikun e jep në formë dialogu më Miranin. Rrjedha e dialogut është me tepër pyetje – përgjigje. Rrëfimi i Premtit përveç që shpalos informacione të rëndësishme për Tarikun, jep një pasqyrë edhe për jetesën e rëndë që ishte bërë në burgjet komuniste.

Në bisedë e sipër shfaqet edhe arsyeja e supozuar se pse ishte burgosur Tarik Saraçi:

UNË

Si silleshin zyrtarët dhe punonjësit e burgut ndaj Tarik Saraçit? Si ndaj gjithë të tjerëve, më mirë apo më keq?

PREMTI

Nuk mund të them prerazi: si? Ndoshta herë më mirë e ndoshta herë më keq. Varej edhe se si sillej Tarik Saraçi ndaj tyre. Si i shikonte, si i përshëndeste! U buzëqeshte apo jo?

Flitej prej të burgosurve, se zyrtari kryesor i burgut, drejtori, e thirrte më shpesh se ndonjë të burgosur tjetër Tarik Saraçin në bisedë. Pse? Për çfarë arsyeje? Për çfarë qëllimi? Donte t'i ndihmonte apo donte të nxirrte farë fjalësh prej tij e, pastaj ta rëndonte që të ridënohej? Nuk e

¹ Shih: Qosja, R., *Bijtë e askujt*, Vajazan, Prishtinë, 2016, f. 113.

di. Dhe, nuk e dinin as të tjerët. Flitej: vetëm Anton Kreshta mund ta dijë. E Anton Kreshta një ditë i kishte pëshpëritur ne vesh një të burgosuri, njërit prej atyre pesë intelektualëve që, po ashtu, si ai, e çmonte dhe e donte shumë Tarik Saraçin: drejtori i burgut e urren aq shumë Tarik Saraçin sa që nuk mund të mos e ftojë aq shpesh në bisedë.

UNË

E pse e urrente ashtu? A dihej pse?

PREMTI

Flitej: shkaku ishte gruaja e Tarik Saraçit, në të cilin edhe drejtori i burgut ishte i dashuruar, qysh se kishte qenë vajzë ajo.

UNË

A mund të jetë edhe kjo ndër arsytet e burgosjes së Tarki Saraçit?

PREMTI

Arsyet e burgosjes së tij, arsytet themelore, ishin vetëm politike.. (Qosja, 2016)

Kapitulli i njëzet e tetë i romanit sjell një copëz teksti më përmbajtje elegjike e cila është dhënë përmes rrëfimit të Tarik Saraçit. Ai aty vajton fatin e vet prej të dëbuarit nga atdheu. Qosja nuk e ka dhënë këtë pjesë teksti as si huazim nga ndonjë shkrim i hershëm i Tarikut e as si krijim të Miranit. Është vet zëri i Tarikut që bëhet zë i narratorit autodiegetik në këtë pjesë. Tariku narrator autodiegetik shfaqet edhe në disa raste të tjera, veçojmë këtu kapitujt ku janë dhënë fragmente nga ditari i Tarikut.

2.2. *Personazhet*: Ndërtimi i personazheve në një vepër letrare është puna më e vështirë dhe më komplekse e autorit, sepse ata janë të përafërt dhe marrin vetitë e qenieve njerëzore, apo siç e thotë Forster se: *aktorët në storje janë, apo pretendojnë të jenë, qenie njerëzore.* (M.E.Forster, 2017)

Të krijohet një personazh i besueshëm ai duhet të pajiset me të gjitha elementet që e kompletojnë atë si njëri. Paraqitja fizike, ana emocionale, mendimet, ana psikologjike, veprimet, qëndrimi ndaj situatave të caktuar, marrëdhënia me personazhe të tjerë. Madje jo rrallë lexuesi arrin më mirë ta njeh një personazh të caktuar letrar kur ai është i ndërtuar dhe kompletuar si duhet, se sa një familjar a shokë.

Ne njohim njëri – tjetrin përafërsisht, me anë të shenjave të jashtme dhe këto shërbejnë si bazë e mjaftueshme për një shoqëri, madje edhe për intimitet. Ndërsa njerëzit në roman, nëse dëshiron romansieri, mund të kuptohen tërësisht nga lexuesi; aty mund të ekspozohet jeta e tyre e brendshme dhe e jashtme. (M.E.Forster, 2017)

Qosja dy personazhet e tij kryesore Miran Bushatin dhe Delina Dertin i ka ndërtuar ndryshe – ndryshe.

Miran Bushati është tip i personazhit të kompletuar. Ai është ndërtuar me të gjitha elementet që ndërtojnë një karakter letrar. Mirani është person i rregullti i cili ka një stil jetese të shëndetshme. Atë e preokupon zgjimi i vonuar në ditën e parë në atdhe gjë e cila nuk i ndodh në Nju – Jork.

Në Nju – Jork kurrë nuk zgjohem kështu vonë bie me kohë – herët dhe zgjohem me kohë – herët. Me miliona vjet krijesa prej së cilës e thotë Darvini se është homo neandertali dhe, pastaj, homo peccatari është mësuar të flejë natën dhe të punojë ditën. Njeriu ka shekuj që po e ndryshon këtë rend në jetën e vet dhe, si pasojë, po shkakton shpërfytyrimin e vet shpirtëror dhe trupor. (Qosja, 2016)

Pohimi i fundit i Miranit tregon se ai është tip i cili kujdeset që të jetë i shëndetshëm, dhe tu përmbahet rregullave shekullore se si duhet të jetojë njeriu.

Qosja ka zgjedhur një mënyrë pak sa të pazakontë për të dhënë një mori informacionesh rreth jetës së Miran Bushatit. Kështu kur Mirani ndodhet në Arkivin e qytetit, ai paramendon pyetjet të cilat dëshirojnë të ia bëjnë punonjësit e Arkivit dhe që hezitojnë të ia bëjnë e që ky si pyetjet ashtu edhe përgjigjet i bluan në mendjen e tij.

Përmes pyetje – përgjigjeve të pabëra kuptojmë që Miran Bushati është me prejardhje prej Boshatlinjeve të panjohur të fshatit e jo nga ata me nam të qytetit. Kuptojmë se babai i Miranit është arratisur në vitin 1949 për në Jugosllavi dhe se nga Jugosllavia për në Amerikë në vitin 1960. Kjo vërtetohet në një farë mënyre se edhe Mirani është i përndjekur nga atdheu.

Miran Bushati ka studiuar etnologji dhe antropologji:

Nuk më pyesin, por unë e marr me mend se do të dëshironin të më pyesnin, se çfarë fakulteti kisha kryer.

Dhe, unë vetë me vete do t'u përgjigjem dhe do t'u përgjigjem më i kapardisur se ç' mund t'u shkojë mendja lexuesve: kam studiuar në Universitetin elitë të Jelit, në Nju – Jork, dhe kam diplomuar etnologjinë dhe antropologjinë, por, tani nuk merrem as me njërën, as me tjetrën, sepse i jam kushtuar letërsisë prej së cilës kam shumë pak dobi se ç' do të kisha prej tyre. Unë nuk e gjej kuptimin e jetës në para, por në krijimtari imagjinare. (Qosja, 2016)

Një veti tjetër që zbulohet këtu për karakterin e Miranit është se ai e bën punën që do dhe që i sjell kënaqësi shpirtërore dhe nuk bën punën për të cilën ka studiuar dhe që mund t'i sjell të ardhura materiale të majme. Miran Bushati është artist dhe jo tregtar.

Miran Bushati nga personazhi pozitiv, i hareshëm dhe entuziast, kthehet në personazh fatkeq dhe të dëshpëruar në fund të romanit kur atij i vritet e dashura. Ai ndihet birë i braktisur njëlloj si Tarik Saraçi.

Delina Derti është një vajzë intelektuale shqiptare e cila po përfundon temën e doktoratës në letërsi. Përshkrimi i dukjes që i bëhet Delina Dertit është shumë i hollësishëm, madje lexuesi mund të krijoj edhe fotografinë e saj nga ky përshkrim plotë:

Ka trup mesatar: as dukshëm e gjatë, as dukshëm e shkurtër.

Ka flokë bojëgruri – si ari thuhet për flokët e tilla në këngët popullore.

Ka sy të kafentë, gati të zinj, disi të mekur.

Ka vetulla hark, të kafta, të holla.

Ka qerpikë të zinj dhe të gjatë, si krahë të dallëndyshes, thuhet për qerpikët e tillë në këngët popullore.

Ka buzë të trasha, të lëngëta, që i çojnë peshë ndjenjat e meshkujve.

Ka bel jo të hollë, por që thyhet fort gjatë ecjes.

Ka këmbë të gdhendura për mrekulli, as të holla, as të trasha, si t'i kishte punuar Botiçeli.

Ka veshur fustan të kaltër prej brokati.

Është gjinjëpërpjetë.

Nuk i shohë as gjerdan në qafë, as hall – halle në pasdorë, as unazë në gisht. Grua e pastolisur në vendin, ku, më kishte thënë nëna shumë herë, gratë stolisen më shumë se në Amerikë, me stoli të arta, të argjendta, të xhevahirta, si turket... (Qosja, 2016)

Këtu përveç që paraqet dukjen e saj fizike, tregohet edhe një pjesë të personaliteti të saj. Ajo dallon nga gratë tjera të Kurnajës, këtë dallim e vë në pah pamja e saj pa stoli gjë që e vë në pah thjeshtësinë e saj.

Delina si karakter di të jetë edhe e vrazhdë kur i është prishur humori dhe është me nerva. Kjo vërehet në rastin kur komunikon në mënyrë jo të sjellshme me kamerierin kur iu ofrohet nxitimthi që të marr porosinë:

Kamerieri na afrohet posa të ulemi.

Urdhëroni! thotë.

Të marrim frymë, i përgjigjet Delina, njeriu bie nga dardha edhe pushon pak.

Kamerieri kërkon falje për nxitimin, dhe, largohet. (Qosja, 2016)

Delina shpesh herë është e shqetësuar, e vrenjtur në fytyrë, e zymte, dhe kjo gjendje bëhet më e dukshme sidomos pasi i bije celulari. Këto sjellje të Delines nuk mund të duhet të merren si arsye që ajo është person me luhatje të humorit, mirëpo, është personi pas celulari ai që i shkakton trazime asaj. Humori i saj i luhatur vije si pasojë e rrethanave.

Qosja është i dhënë edhe në përzgjedhjen e emrave të personazheve. Këtë preokupim rrethe emrave të personazheve ai e ka shprehur edhe përmes personazhit të tij Miranit kur thekson vështirësitë rreth procesit të krijimit të romanit.

Do të përzgjedhësh temën; subjektin; motivet; do të përzgjedhësh personazhet, meshkuj, femra, pleq, fëmijë; do të përzgjedhësh emrat e personazheve – oh sa të rëndësishëm janë emrat – vetëm shkrimtarët e rendit të fundit nuk lodhen për emrat e personazheve, a vlejnë a nuk vlejnë, a kanë a nuk kanë kuptim, a janë të një a të shumëkuptimshëm;.... (Qosja, 2016)

Edhe emri Miran Bushati edhe ai Delina Derti janë emra të motivueshëm nga karakteret e personazheve.

Studiuesi Ag Apolloni emrin të Miranit i ka dhënë këtë interpretim: *emri Miran është një anagram i emrit Marin, kurse Bushati të sjellë ndër mend familjen e famshëm të Bushatllinjve të Shkodrës.*² (Apolloni, 2016) Për mbiemrin e tij të njëjtin pohim e jep edhe vet protagonistin brenda librit: *babai im ishte i lumtur pse nuk vinte prej atyre Bushatllinjve të lavdishëm të qytetit, por prej atyre Bushatllinjve të panjohur të fshatit – prej fshatarëve.* (Qosja, 2016)

Një interpretim ndryshe i jep këtij emri studiuesja Feride Papleka:

Shkrimtari Miran Bushati, emrin e të cilit autori e ka zgjedhur, duke lënë të kuptohet mirësia dhe të gjitha cilësitë që rrjedhin prej saj,....Ai bie në dashuri me ndihmësen e tij, Delina Derti, mbiemri i së cilës lidhet me brengën e saj të heshtur. (Paplekaj, 2011,2012)

2.3. *Vendi:* Hapësira dhe vendi ku zhvillohen ngjarjet brenda romanit janë të një rëndësie të veçantë. Jo rrallë rrethanat në ngjarje bëhen të ndryshme të ndikuara edhe nga ambienti ku janë të vendosur.

Çdo ngjarje , veprim, personazh a objekt lidhet me hapësirën, më vendin. S'ka ngjarje pa vend. Të gjitha e kanë vendin e vet. Por, hapësira nuk është vetëm ajo ku ndodhë ngjarja, por edhe ajo ku nuk ndodh. Domethënë, ka hapësirë jashtë ngjarjes, por s'ka ngjarje jashtë hapësirës. (Apolloni, Paradigma e Proteut, 2012)

Hapësira në të cilat zhvillohen ngjarjet në roman si lokacione janë tre: Amerikë, Shqipëri dhe Kosovë. Mund të përfshihet edhe Serbia më intensitet më të ulët.

Janë një mori vendesh³ në të cilat zhvillohen ngjarjet. Qoftë historia primare që gërshehet mes Miranit dhe Delines qoftë ajo sekondarë që zhvendoset në kohën kur ka jetuar Tarik Saraçi. Lokacion fillestar kemi Amerikën atje edhe ku jeton Miran Bushati. Ai atje fillon misionin e tij për zbardhjen e fatit të Tarik Saraçit, njëherësh edhe shkrimin e romanit të tij. Si vende të dhëna veçojmë Muzeun e Historisë së Natyrës dhe restorantin Brontozauri.

Më pas lokacionet dhe ambientet ku zhvendoset ngjarja janë shumë vende varësisht si e kërkon natyra e rrëfimit. Kemi ngjarje që zhvillohen në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Ambiente të jashtme janë rrugët, sheshet, parqet, malet, zonat kufitare dhe ambiente të tjera rrethuese në të cilat ecin dhe veprojnë personazhet, veçojmë hapësirën për rreth monumenteve kulturore që vizitojnë protagonistet, qoftë Piramida në Tiranë e me pas objektet e tjera në Kosovë si Sahat Kulla e monumenti i Bashkim – Vëllazërimit. Po ashtu duhet të cekim edhe rrugën përgjatë të cilës ecin Mirani me Delinen teksa shkojnë në kremten e Ditës së Krijuesit, ku në rrugë e sipër edhe bisedojnë me plakun që është një lloj parashikuesi i fatit.

Në ambiente të brendshme mund të veçojmë: aeroplanin gjatë rrugëtimit të Miranit në Shqipëri, taksinë, hotelin ku vendoset Mirani *Tre vëllezërit dhe tri nuset e tyre*, Arkivat dhe Bibliotekat ku Mirani bashkë me Delinen hulumtojnë për jetën e Tarikut, më pas restorantet dhe kafene, ku zhvillohen edhe takime me protagonist të tjerë që rrëfejnë për jetën e Tarik Saraçit, çelite e burgut, zyrat e hetuesisë e po ashtu nuk duhet lënë anash edhe banesat e disa personazheve që i vizitojnë Mirani e Delina, shtëpia e Baba Musasë si dhe përfundimisht salla ku zhvillohet festa për Ditën e Krijuesit. Në atë sallë zhvillohet edhe veprimi më tragjik i gjithë romanit, ku në mes

² Apolloni, A., *Parabola Postmoderne*, OM, Prishtinë, 2016, f. 218.

³ Vend quhet vetëm ajo pjesë ku ndodhë ngjarja. (Apolloni, A., *Paradigma e Proteut*, OM, Prishtinë, 2012, f. 155.)

të hollit të saj ndodhë vrasja e Delina Deriti nga ish bashkëshorti që i jep gjithë romanit një zymtësi dhe njollë gjaku i cili personifikon burrin prapambetur dhe të pakulturuar që mendja e tij di t'i zgjidhe problemet vetëm me posedim apo përmes shkrepjes së armës.

2.4. *Koha*: Zhvillimi i ngjarjeve narrative ndodhin në periudha kohore. Nuk mund të këtë rrëfim të vazhdueshëm e të mos jetë i vendosur në kohë.

Ngjarjet janë përcaktuar si procese. Një proces është ndryshim, zhvillim dhe presupozon pra një suksesion në kohë ose në kronologji. Vetë ngjarjet ndodhin gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe ndodhin në një rend të caktuar. Disa narrativa janë të rëndësishme pikërisht për shkak të kohëzgjatjes. (Bal, 2021)

Ngjarjet në romanin *Bijtë e askujt*, janë të vendosura në mënyra të ndryshme në marrëdhënie me kohën. Linja e ngjarjeve të Miran Bushatit, si hulumtues dhe shkruar i jetës së Tarik Saraçit, ka një rrjedhë kronologjike dhe ecuria e saj është e vazhdueshme nga fillimi drejt fundit. Procesi i punës së hulumtimit për jetën e Tarikut merr një periudhe relativisht të gjatë kohore që bëjnë ditë, javë e muaj.

Periudha sa zgjate hulumtimi mund të llogaritet rreth dy muaj e disa ditë, nëse kemi parasysh letërkëmbimet që bën Mirani me Arben Begeja dhe më Gjinush Saraçin.

Në letrën e parë që i shkruan Arbeni Miranit, e që është e datës: 9 tetor 2006 ku i thotë: *U bënë shumë ditë, ndoshta, tri javë prej se nuk jemi dëgjuar*. Tri javë nga data nëntë, tetor i bije diku mesi i shtatorit, kurse në letrën e fundit që Mirani i shkruan Gjinushit, ku edhe e njofton për përfundimin e romanit, është e datës 21 nëntor⁴, atëherë mund të supozojmë se periudha kohore e shkrimit të romanit mund të jetë ajo që e thamë më lartë.

Rrjedha e ngjarjeve në roman shpesh bën kthim retrospektiv, sidomos në situata kur rrëfëhet e kaluara dhe historitë për Tarik Saraçin. Mirëpo edhe brenda atyre ngjarjeve të rrëfyera në të kaluarën hasen ngjarje të cilat përfshihen e që shtyhen edhe me tutje në kohë, nuk është pra vetëm një nivel i kalimit në kohë nga e tashmja mirëpo shkon edhe në më shumë nivele si në rastin kur Tariku mendon fëmijërinë e tij:

Mendoj babai:

Kur udhëtonim me karvanë për Stamboll, pastaj, prej Stambolli në Kurnajë, shumë herë kemi fjetur në varrë. Nuk ka gëzim më të madh se gëzimi që ndien kur të del gjumi në varre. E kupton çka do të thotë të jesh gjallë të jetosh. (Qosja, 2016)

Aksioni diversant i Tarik Saraçit dhe dy të tjerëve që marrin për në Kurnajë është i planifikuar që të përfundoj në një periudhë kohore pesë ditore, në rasti nevojë mund të zgjas edhe pese ditë të tjera mirëpo kurrsesi më tepër. Është kjo një pjesë e ngjarjeve të cilat duhet të zhvillohen brenda një periudhe kohore të llogaritur. Aksioni nis me dhjetë qershor dhe supozohet që përfundon më shtatëmbëdhjetë qershor, sepse ajo është edhe data e fundit kur Tariku shkruan në ditarin e tij dhe nga aty e tutje nuk ka më të dhëna për fatin e tij.

Kohëzgjatja e aksionit do të duhet të ishte e njëjtë për të tre diversantët, mirëpo Tariku me tu kthyer në vendin e planifikuar për takim nuk i gjen dy personat e tjerë. Kjo e detyron atë të pres edhe për ca kohë kthimin e tyre.

⁴ Shih: Qosja, R., vepra e cituar, f. 628.

3. Përfundimi

Këndvështrimi narratologjik mbi romanin *Bijtë e askujt*, dëshmon se ndërtimi strukturor narrativ që ka aplikuar Qosja, nuk është vetëm një zgjedhje e rastësishme, por një mekanizëm i fuqishëm për të paraqitur realitetin e hidhur historik të një shoqërie në një periudhë të rëndë siç ishte ajo komuniste. Narrativat e romanit, llojet e ndryshme të narratorëve, zhvendosjet kohore në të kaluarën që shërbejnë për ndërlidhje ngjarjesh dhe evokim të kujtimeve, kanë krijuar një kompleksitet narrativ i cili hynë në funksion si aspekt estetik e artistik, por edhe për të reflektuar mbi atë realitet ku identiteti njerëzor është zhvlerësuar nga presioni politik diktatorial.

Narracioni i romanit si e tillë paraqet tensionin e një periudhe dhe tenton të sjellë zërin e atyre të cilët kanë qenë të keqtrajtuar e të përjashtuar duke u ndjerë si bijtë e askujt në atdheun e tyre. Është kjo një kritikë që Qosja e ka ndërtuar në mënyrë të heshtur, por të fuqishme për të goditur sundimin komunist për të ligat që u ka shkaktuar dy vendeve të ndryshme në Shqipëri dhe në Kosovë.

Përfundimisht romani *Bijtë e askujt* i Rexhep Qosjes, është roman i thellë i cili nuk shteron së ofruari elemente të rëndësishme për studim, jo vetëm nga ana narratologjike, mirëpo në të gjitha nivelet dhe praktikën e studimit.

Rexhep Qosja në këtë roman ka krijuar llojin e romanit gjithëpërfshirës zhanror e kulturor që kërkon punë dhe përkushtim të madh në interpretim dhe studim.

References

- [1]. Apolloni, A. (2012). *Paradigma e Proteut*. Prishtinë: OM.
- [2]. Apolloni, A. (2016). *Parabola postmoderne*. Prishtinë: OM.
- [3]. Bal, M. (2021). *Narratologjia*. Prishtinë: Artini.
- [4]. M.E.Forster. (2017). *Aspekte të romanit*. Prishtinë: Parnas.
- [5]. Papekaj, F. (2011,2012). Romani i romaneve - "Bijtë e askujt" I - II i Rexhep Qosjes. *Gjurmime albanologjike*, ff. 341 - 342.
- [6]. Qosja, R. (2016). *Bijtë e askujt*. Prishtinë: Vajazan.